



Prishtinë, 29.07.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1563_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2312_06_21** i dt.06.06.2022;
- Ankesa e konsumatorit e datës **04.07.2022**,

në seancën e mbajtur më datë **29.07.2022** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Sh. V., nga komuna e Malishevës si e pabazuar;
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2312_06_22, i datës 06.06.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 06.06.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2312_06_22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit si të pabazuar dhe e ka obliguar KESCO-n që t'i ofroj konsumatorit kontratë pagese 85 mujore për korrigjimet plotësuese nr. 25808DGJ-80004470, nr.25809DGJ-80004470, nr.258010DGJ-80004470 dhe nr. 25811DGJ-80004470 datë 05.06.2018.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori Sh. V., brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Konstaton se punëtorët e autorizuar të KEDS-it ashtu edhe DMK-ja kanë ardhur në konstatim të gabuar, përkundër që DMK ka për obligim të mbrojë konsumatorët;
- Konstaton se njehsori është vendosur menjëherë pas luftës së vitit 1998/99 dhe se njehsori ka qenë i ri, është vendosur nga punëtorët e KEDS-it dhe i njëjti është faturuar në mënyrë të rregullt;
- Konstaton se asnjëherë nuk është bërë vërejtje apo kërkesë për largimin e njehsorit apo ndonjë dëm që mund të mos jetë i saktë në regjistrimin e energjisë së shpenzuar;
- Konsumatori kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të anulohet vendimi e DMK-së ZRRE/DMK_V_2312_06_22 i datës 06.06.2022 dhe lirin nga borxhi i ngarkuar.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi është i kundërligjshëm dhe kontradiktor me veten, Bordi thekson se, nuk qëndron një pretendim i tillë, për faktin se, me kujdes dhe ndërgjegje është analizuar çdo provë veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, si në vijim: Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0857255 datë 31.10.2017; Procesverbali i inspektimit nr. 2522551 datë 10.11.2017; Procesverbali i inspektimit nr. 2523501 datë 06.12.2017; Protokollin i shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 59 datë 03.01.2018; Procesverbali i kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr.404 datë 09.01.2018; Korrigjimet plotësuese nr. 25808DGJ-80004470, nr. 25809DGJ-8000447, nr. 258010DGJ-80004470 dhe nr. 25811DGJ-80004470 datë 05.06.2018; Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 05.01.2018; Përgjigja e KESCO-s e datës 16.11.2021; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 16.12.2021; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK_V_2312_06_22 i datës 06.06.2022; Ankesa e konsumatorit e datës 04.07.2022; Faturat e konsumatorit; Transaksionet e konsumatorit dhe Rrjedha e energjisë elektrike dhe ka gjetur se, ankesa e konsumatorit Sh. V., është e pa bazuar.

Bordi pas analizimit të të gjitha dëshmive të paraqitura nga ana e konsumatorit dhe të licencuarit KESCO, ka vërejtur se, fillimisht me datë 31.10.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 35371982, me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=26692 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 39304143 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse si dhe kanë evidentuar që konsumatori nuk e dorëzon njehsorin e vjetër. Tutje me datë 10.11.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse me qëllim të largimit nga matja të njehsorit të vjetër por që kanë evidentuar se konsumatori nuk lejon që të merret njehsori nr. 35371982. Ekipi i KEDS-it po ashtu ka evidentuar se përmes njehsorit të ri të vendosur furnizohen dy shtëpi dhe se konsumatori nuk lejon regjistrimin e pajisjeve që posedon në momentin e inspektimit. Departamenti i faturimit në KESCO me datë 05.06.2018 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjimet plotësuese nr. 25808DGJ-80004470, nr. 25809DGJ-80004470 dhe nr. 258010DGJ-80004470 dhe nr. 25811DGJ-80004470 në vlerë financiare **13,549.17€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 11/2010 deri në periudhën 11/2017 për shkak të faturimit të gabuar bazuar në procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 59 datë 03.01.2018. Bordi ka shqyrtuar korrigjimet plotësuese nr. 25808DGJ-80004470, nr. 25809DGJ-80004470, nr. 258010DGJ-80004470 dhe nr. 25811DGJ-80004470 të datës 05.06.2018 në vlerë financiare **13,549.17€** për faturat e periudhës 11/2010 deri në periudhën 11/2017 për shkak të faturimit të gabuar, përkatësisht shpenzimet e regjistruara dhe faturuara në atë periudhë në njehsorin elektrik nr. 35371982 janë faturuar si njehsorë 5 shifror kurse njehsori elektrik sipas procesverbalit të shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 59 datë 03.01.2018 ka qenë 6 shifrorë dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *"Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet*



(rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese". ZRrE duke pasur parasysh argumentet e përmendura më lartë si dhe mos faturimin e saktë të konsumatorit për periudhën 11/2010 deri në periudhën 11/2017 konstaton se konsumatorit duhet t'i ofrohet kontratë pagese prej 85 (tetëdhjetë e pesë) muajve.

Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik kontestues konstatohet se tek konsumatori lexuesi i KEDS-it ka bërë lexime të sakta mujore dhe se në asnjë rast nuk ka evidentuar se ka lexim jo të saktë por që në disa raste ka evidentuar se vjetërsia e njehsorit është mbi kufi. Bordi po ashtu bazuar në analizimin e tre procesverbaleve, procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0857255 datë 31.10.2017, protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 59 datë 03.01.2018 dhe procesverbalit të kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr.404 datë 09.01.2018 konstaton se ka mos përputhje të të dhënave të shpenzimeve. Në procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0857255 datë 31.10.2017 gjendja e shpenzimeve të regjistruara është TL=00000 kWh dhe TU=26692 kWh, protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 59 datë 03.01.2018 është TL=270839 kWh dhe TU=000009 kWh kurse në procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr.404 datë 09.01.2018 është TL=000010 kWh dhe TU=270843 kWh dhe se korrigjimi i kWh është bërë duke marr për bazë protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 59 datë 03.01.2018. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike vërtetohet se konsumatori nga periudha 11/2010 i është ndërruar gjendja e faturimit përkatësisht në vend që të faturohet si 6 shifror nga kjo periudhë ka filluar të faturohet si 5 shifror deri në periudhën 11/2017 kur edhe është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik. Po ashtu sipas rrjedhës së energjisë konstatohet se konsumatori pas ndërrimit të njehsorit elektrik ka rritje të madhe të shpenzimit.

ZRrE ka shqyrtuar faturimin e periudhës 11/2010 deri në periudhën 11/2017 për të cilën edhe është bërë korrigjimi plotësues dhe konstaton se KEK dhe KESCO për këtë periudhë të faturimit nuk kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjerë, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit Sh. V., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.